



**VENDIM**

**Nr. 89 Datë 26.09.2011**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT  
TË SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SH.P.K PËR  
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR “HEC KLOS” SI  
BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “ll”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MALIDO ENERGJI” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC KLOS” si burim i rinovueshem energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “MALIDO ENERGJI” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Pershkrimi i pergjithshem i centralit.  
Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e pergjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion eshte paraqitur ne menyre korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gwrmat “a”, “b”, “c”**  
Pwrshkrimi i centralit..  
Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**VENDOSI :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “MALIDO ENERGI” sh.pk, për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC KLOS” si burim i rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.